
QAINT
Quality, Accountability, Integrity and Transparency in Higher Education

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

PRISHTINË, TETOR 2022

3 VITE HULUMTIM DHE MONITORIM I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË



3 VITE

HULUMTIM DHE MONITORIM I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

Tetor 2022, Prishtinë

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6
Prishtina, 10000, Kosova

Autore:
Adea Kondirolli

Hulumtues dhe bashkëautorë:
Elena Morina
Liridona Ademaj
Skord Retkoceri

Dizajni:
Envinion

Tetor 2022, Prishtinë



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje 9

MONITORIMI I KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË (AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM) 10
- 2019 11
- 2020 11
- 2021 12
- 2022 13

MONITORIMI I QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE TË DIPLOMAVE (NARIC KOSOVA) 14
- 2019 15
- 2020 16
- 2021 17
- 2022 19

Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - Menaxhimi i Financave 20

Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës – Transparenca formale 28

Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në universitete publike 33
- Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Prishtinës 36
- Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Mitrovicës 39
- Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Gjakovës 42
- Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Prizrenit 45
- Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Pejës 48
- Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Gjilanit 51
- Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Ferizajit 54

LISTË E SHKURTESAVE

- **UP -** Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
- **UHZ -** Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
- **UPZ -** Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”
- **UGJFA -** Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
- **UMIB -** Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
- **UKZ -** Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
- **USHAF -** Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- **ORCA -** Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
- **MAShTI -** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- **AKA -** Agjencia e Kosovës për Akreditim
- **KShC -** Këshilli Shtetëror i Cilësisë
- **IAL -** Institucion i Arsimit të Lartë
- **ENQA -** Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- **EQAR -** Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- **NARIC Kosova -** Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik
- **KShNj -** Këshilli Shtetëror për Njohje

HYRJE

Më 1 prill 2019, Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), Qendra Kosovare për Arsim (KEC) dhe Qendra për Inovacion Social (ZSI) filluan projektin QAINT (Cilësi, llogaridhënie, integritet dhe transparencë në arsimin e lartë) të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Projekti kishte për synim që të bashkërendojë sistemin e arsimit të lartë në Kosovë me standardet ndërkombëtare të cilësisë, transparencës, integritetit dhe llogaridhënies. Ndikimi afatgjatë i këtij projekti është përmirësimi i cilësisë dhe aftësisë konkurruese të sektorit të arsimit të lartë me qëllim që t'i kontribuojë zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të vendit.

Në kuadër të këtij projekti, tre organizatat kanë pasur synim të ngrisin kapacitetet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për të monitoruar ofruesit e arsimit të lartë dhe këshillimi i MAShT mbi rezultatet e vlerësimit të cilësisë, si dhe përmirësimi i kredibilitetit të procesit të akreditimit.

Projekti po ashtu synonte përmirësimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në sektorin e arsimit të lartë. QAINT ndihmoi në përmirësimin e legjislacionit (rregulloreve, procedurave dhe praktikave) lidhur me çështjet akademike në arsimin e lartë. Si dhe në përmirësimin e kapacitetit të stafit të ri akademik (asistentëve/teve të rinj/reja dhe/ose atyre që i kanë përfunduar studimet e doktoratës) për të ushtruar mësimdhënie të mbështetur në punë hulumtuese.

Në kuadër të synimit të dytë të projektit, në përmirësimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies, ORCA ka hulumtuar dhe monitoruar një sërë institucionesh të arsimit të lartë, duke përfshirë të gjitha universitetet publike, Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Qendrën NARIC në kuadër të Ministrisë së Arsimit, dhe institucione tjera që lidhen me arsimin e lartë.

Përgjatë tre viteve të projektit, ORCA ka prodhuar 21 raporte hulumtuese dhe monitoruese mbi këto institucione. Në vijim do i trajtojmë rezultatet kyçe të këtyre hulumtimeve përgjatë tre viteve të fundit, me përditësimet e fundit.

MONITORIMI I KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË (AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM)

KShC përmirëson praktikat e saj të punës, transparencën dhe llogaridhënien, dhe rianëtarësohet si anëtar i asocuar në ENQA pas përjashtimit në 2019.

AKA është themeluar në vitin 2004 dhe ka filluar operimin e saj, si trup formal për akreditim në Kosovë që nga viti 2009. AKA është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

Agjencia është përgjegjëse për procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, përcakton standardet dhe harton procedurat e saj për sigurimin e cilësisë në përputhje me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare për cilësi në arsimin e lartë.

AKA përbëhet nga bordi i saj - Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), i cili është organ politikbërës dhe vendimmarrës, si dhe struktura e përhershme administrative e AKA-së.

KShC merr vendim për akreditim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet, por asnjë vendim i KShC-së për akreditim/riakreditim nuk mund të merret pa pjesëmarrjen e të paktën një anëtari ndërkombëtar.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë gjatë periudhës janar 2019 - gusht 2022, i kishte dhënë akreditim institucional 27 Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), prej tyre 20 private dhe 7 publike. Ndërkaq pa akreditim institucional, ishin 3 IAL publike dhe 28 IAL private. Numri i programeve studimore që kanë pasur akreditim gjatë periudhës janar 2019- gusht 2022 në IAL publike është 670, ndërsa në IAL private është 474.

2019

Këshilli Shtetëror i Cilësisë gjatë vitit 2019[1], i kishte dhënë akreditim institucional 10 Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), prej tyre 9 private dhe 1 publike. Numri i programeve studimore që kanë pasur akreditim gjatë vitit 2019 në IAL publike është 173, ndërsa në IAL private është 120. Me akreditim institucional, ishin 6 IAL publike dhe 15 IAL private. Ndërkaq pa akreditim institucional, ishin 3 IAL publike dhe 8 IAL private.

Në shtator të 2019-ës, Agjencia kishte pranuar vendimin përfundimtar të ENQA-së, në të cilin thuhej se AKA-së nuk i ishte vazhduar anëtarësia, me arsyetimin se nuk i përmbushin më standardet dhe rregullat evropiane, si dhe kishte mangësi të theksuara në udhëheqjen e saj.

2020

Gjatë vitit 2020[2], KShC kishte dhënë riakreditim institucional për 4 Institucione të Arsimit të Lartë (IAL), 1 private dhe 3 publike. Numri i programeve studimore me akreditim gjatë vitit 2020 në IAL publike ishte 233, ndërsa në IAL private ishte 128. Me akreditim institucional ishin 9 IAL publike dhe 12 IAL private, ndërsa pa akreditim institucional ishin 10 IAL private.

Në janar të vitit 2020, Inspektorati i Arsimit në MASh kishte bërë kallëzim penal ndaj Kolegjit UBT në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe ishin hapur hetime nën dyshimin se kishin tejkaluar numrin maksimal të regjistrimit të studentëve në programe studimi. Ndërsa në qershor të po atij viti, është dorëzuar një peticion me 293 nënshkrime të studentëve të Kolegjit Heimerer tek sekretari i përgjithshëm në Ministri të Arsimit, pasi kishin verifikuar në po të njëjtën ministri se nuk ishin të regjistruar si studentë në Sistemin e Menaxhimit të Informatave për Arsimin e Lartë (SMIAL).

Gjatë vitit 2020, është publikuar një hulumtim nga një medium përmes të cilit është publikuar rrëfimi i një studenteje të Kolegjit Rezonanca, e cila pretendonte se ishte mashtruar nga ky kolegj se kishin akreditim në programin ku ajo ishte regjistruar15. Kolegji kishte deklaruar se besonte që KShC do t'iu jepte akreditim për vitin akademik 2019/2020 meqenëse u lejohet riaplikimi sipas udhëzimit administrativ të ri dhe nëse nuk u jepej

1 RAPORTI I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË, MARS 2020, linku: http://orca-ks.org/ëp-content/uploads/2017/02/Raporti-Monitorimit-te-Keshillit-Shteteror-06.pdf

2 RAPORT I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË 2, SHKURT 2021, linku: http://orca-ks.org/ëp-content/uploads/2021/02/Raporti-Monitorimit-te-Keshillit-Shteteror-2.pdf

akreditim për atë vit akademik, ata do ta padisnin këtë institucion. KShC nuk kishte akreditуar programin e kërkuar nga kolegji në fjalë për vitin akademik 2019/2020 por vetëm për vitin akademik 2020/2021.

2021

Gjatë vitit 2021[3], akreditim institucional kishin marrë 7 Institucione të Arsimit të Lartë (IAL), prej tyre 5 private dhe 2 publike. Numri i programeve studimore me akreditim gjatë vitit 2021 në Institucione të Arsimit të Lartë publik ishte 227, ndërsa në IAL private ishte 171. Me akreditim institucional, ishin 9 IAL publike dhe 15 IAL private. Ndërkaq pa akreditim institucional, ishin 8 IAL private.

Në tetor të vitit 2021, ishte publikuar Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, në të cilin ishte trajtuar edhe progresi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Në këtë raport thuhej se Agjencia e Kosovës për Akreditim është duke vazhduar me përpjekjet për të rifituar anëtarësinë në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR). Ishte evidentuar se kapacitetet e agjencisë ishin rritur me katër zyrtarë në vitin 2020 dhe se si gjatë vitit 2021 ishin hapur edhe tetë pozita të lira. Tutje ishte thënë se agjencia ka arritur të përfundojë ciklin e plotë të akreditimit për vitin akademik 2021-2022, duke e ulur numrin e programeve dhe institucioneve bazuar në kriteret e cilësisë. Më pas ishte thënë se janë emëruar anëtarë të rinj në bordin e AKA-së, të cilët ishin përzgjedhur përmes procedurave transparente.

Njëra ndër 13 rekomandimet e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ishte edhe krijimi i një ligji i cili rregullon punën dhe funksionimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim por që në të njëjtën kohë edhe e siguron pavarësinë e saj dhe zbatimin e standardeve evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Në dhjetor të vitit 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i cili e rregullon statusin e Agjencisë si agjenci rregullatore në proceset dhe përgjegjësitë e akreditimit, riakreditimit, validimit dhe monitorimit. Ky projektligj është duke kaluar në fazat e nevojshme shqyrtuese para hyrjes në fuqi.

3 RAPORT I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË NË AGJENCI TË KOSOVËS PËR AKREDITIM 3, PRILL 2022, linku: http://orca-ks.org/ëp-content/uploads/2022/05/Raporti-monitorimit-KSHC-3.pdf

Njëra ndër rekomandimet e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ishte miratimi dhe funksionalizimi i Metodologjisë së Monitorimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë. Kjo komponentë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim nuk ka qenë aktive as gjatë vitit 2021 dhe mungesa e monitorimit të mirëfilltë nga AKA-ja ndaj institucioneve të cilave i ka dhënë akreditim, ka qenë evidente ndër vite.

Në shkurt të vitit 2021, tre anëtarët ndërkombëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Jeff Butel, Herb Amato dhe Magdalena Ziolo kishin dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre në të cilat ishin emëruar në vitin 2018. Shkaktar i këtij veprimi, ishte kërkesa e Agjencisë Kundër Korrupsion për zbatimin e Ligjit për deklarimin e pasurisë8, i cili obligon që të gjithë zyrtarët publik ta deklarojnë pasurinë e tyre. Tutje në qershor të po atij viti, Kuvendi i Kosovës kishte emëruar shtatë anëtarët e rinj vendor dhe ndërkombëtarë, Hasnija Ilazi, Krenare Pireva-Nuçi, Seb Bytyçi, Gëzim Tosuni, Alison Felce, Cassie Barnhardt dhe Ëerner Stueber me mandat pesëvjeçar. Mirëpo ende pa u mbushur një muaj që nga emërimi i tyre, anëtarët ndërkombëtar prezantuan dorëheqjet e tyre pas kërkesës për deklarim të pasurisë. Sipas tyre, problemi dhe arsyeja kryesore nuk ishte vetëm deklarimi i pasurisë por publikimi i atyre informatave. Në tetor të vitit 2021, Kuvendi i Kosovës kishte emëruar Klemen Miklaviç si anëtarë ndërkombëtarë në Këshillin Shtetëror të Cilësisë dhe ky bord i ishte kthyer funksionalizimit.

2022

Gjatë vitit 2022, KShC ka dhënë riakreditim institucional për 6 Institucione të Arsimit të Lartë (IAL), 5 private dhe 1 publike. Ndërkaq nuk ka riakredituar 2 institucione private. Numri i programeve studimore të aprovuara për akreditim/riakreditim gjatë vitit 2022 në IAL publike është 37, ndërsa në IAL private është 55. Numri i programeve që nuk janë akredituar në IAL publike janë 5, ndërkaq në IAL private janë 16. Janë validuar edhe 2 programe nga IAL private.

Përmes projektit QAINT të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Agjencia e Kosovës për Akreditim kishte pranuar draftin fillestar të Metodologjisë së Monitorimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë, i cili nuk kishte arritur të aprovohej nga bordi i kaluar. Mirëpo pas emërimit të anëtarëve të ri të bordit dhe drejtorit të Agjencisë, ky dokument është aprovuar në shkurt të vitit 2022.

MONITORIMI I QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE TË DIPLOMAVE (NARIC KOSOVA)

NARIC Kosova përmirëson transparencën, llogaridhënien dhe praktikat e punës së saj. Në 2021, MAShTI themelon Komisionin për Validim të Diplomave të fituara në Kosovë, pas lajmit që mund të jenë deri në 20,000 diploma jovalide në Kosovë. Ky komision ka validuar më shumë se 5000 diploma deri tani.

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC – National Academic Recognition and Information Center), e përbërë nga Zyra e Qendrës dhe Këshilli Shtetëror për Njohje, ofron informacion në procedurat për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja, si dhe ofron informata për sistemin e arsimit të lartë dhe kualifikimet në Kosovë me kërkesë të shteteve tjera.

Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) është organi brenda qendrës NARIC i cili merr vendime për njohje/ barasvlerë apo mosnjohje/mosbarasvlerë, duke u bazuar në dosjen e parashtruesit të kërkesës dhe raportin e përgatitur nga zyrtari i Qendrës dhe në raste të veçanta, bazuar në rekomandimin e komisionit të ekspertëve. Përbëhet nga profesorë universitar të fushave të ndryshme studimore.

Njohja nënkupton pranimin zyrtar nga ana e Ministrisë së Arsimit të një diplome të fituar jashtë vendit. Barasvlerësimi nënkupton pranimin zyrtar nga ana e Ministrisë së Arsimit të një diplome të fituar jashtë vendit dhe krahasimin e saj me nivelin e diplomave dhe fushës studimore në vendin tonë.

Qendra NARIC po ashtu bën validimin e diplomave të fituara në Kosovë për përdorim

jashtë vendit. Vlefshmëria e diplomës vërteton ekuivalencën e kredive dhe të diplomës së çdo certifikimi të fituar në cilindo nga institucionet e akredituara në Kosovë, që mbajnë një akreditim ekuivalent. Ky shërbim i certifikimit të diplomës ka për qëllim lehtësimin e pranimit të diplomave dhe kredive të fituara nga institucionet e akredituara brenda vendit.

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), gjatë periudhës prill 2019-gusht 2022 kishte njohur gjithsej 2620 diploma. Ndërkaq nuk kishte njohur 29 diploma nga nivele të ndryshme studimi.

Ndërkohë që në proces, gjatë kësaj periudhe kanë qenë 1028 lëndë të cilave ndër vite nuk u është dhënë përgjigje nga institucionet ku palët i kanë përfunduar studimet, apo nga qendrat NARIC të shteteve përkatëse.

2019

Në periudhën kohore prill – dhjetor 2019[4], janë marrë gjithsej 970 vendime nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), ndërkohë që në proces, janë 485 lëndë të cilave ndër vite nuk u është dhënë përgjigje nga institucionet ku palët i kanë përfunduar studimet, apo nga qendrat NARIC të shteteve përkatëse.

Sa i përket numrit të lëndëve apo diplomave të vlerësuara nga Zyra e Qendrës NARIC dhe jo nga Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj), për diplomat e fituara në universitete botërore dhe rajonale, vetëm gjatë periudhës prill-dhjetor të vitit 2019, numri i përgjithshëm arrin në 529. Prej tyre, 161 diploma janë miratuar nga niveli Bachelor i studimeve, 247 nga niveli Master dhe 121 nga niveli i doktoratës.

Numri i përgjithshëm i diplomave të njohura dhe atyre të refuzuara për periudhën prill-dhjetor të vitit 2019, është 970. Nga niveli i pestë janë miratuar 4 diploma, nga niveli Bachelor janë miratuar 324 diploma ndërsa janë refuzuar 4 të tilla. Në nivelin Master janë miratuar gjithsej 429 diploma, ndërsa janë refuzuar 2. Në nivelin e doktoratës, janë miratuar 207 diploma nga NARIC Kosova.

4 RAPORTI I MONITORIMIT TË NARIC KOSOVA, PRILL – DHJETOR 2019, linku: http://orca-ks.org/ëp-content/uploads/2017/02/RAPORTI-I-MONITORIMIT-T%C3%8B-NARIC-KOSOVA-ALB-03.pdf

Problemet me të cilat u ballafaqua NARIC Kosova gjatë këtij viti përfshinin:

Mungon databaza interaktive e cila do t'i shërbente sistemit të arsimit parauniversitar dhe të lartë në Kosovë (psh. cilat shkollime të arsimit të mesëm të lartë japin qasje për vazhdim të mëtutjeshëm; në cilat raste matura nuk është obligative etj.). Kjo lloj databaze do të publikohej në ueb të NARIC-ut dhe do të shërbente për shtetet tjera, të cilat kanë nevojë për informata rreth sistemit të arsimit në Kosovë.

Mungesa e stafit apo kapaciteteve njerëzore, sipas këtyre zyrtarëve ka vite që po ua pamundëson atyre ndjekjen apo shqyrtimin e rasteve në kohë, për shkak të vëllimit të madh të lëndëve.

Nevojitet krijimi i një ligji të veçantë që e rregullon punën në NARIC, meqenëse sipas rregullores së re të MAShT-it, NARIC nuk është pjesë e Arsimit të Lartë dhe se fushëveprimi i kësaj qendre është shumë më i gjerë, pasi që përfshinë edhe arsimin parauniversitar. Si pasojë e mungesës së një ligji të veçantë, Gjykata e Apelit ka obliguar MAShT-in, konkretisht KShNj-në, që të zbatoj vendimin e saj për njohjen e diplomës së doktoratës të një kandidati.

Mungon edhe rregullorja për punën e Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj), përmes të cilës përcaktohet mënyra e punës së këtij këshilli siç janë thirrja e mbledhjes, mbajtja, mënyra e vendosjes apo votimit për lëndë, zbatimi i vendimeve dhe çështjeve tjera përkatëse.

2020

Në periudhën kohore janar-tetor të vitit 2020[5], janë marrë gjithsej 663 vendime nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), ndërkohë që në proces, janë 194 lëndë apo diploma të cilave nuk u është dhënë përgjigje nga institucionet ku palët i kanë përfunduar studimet, apo nga qendrat NARIC të shteteve përkatëse.

Sa i përket numrit të lëndëve apo diplomave të vlerësuara nga Zyra e Qendrës NARIC dhe jo nga Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj), për diplomat e fituara në universitete botërore

5 RAPORTI I MONITORIMIT TË NARIC KOSOVA 2, JANAR – TETOR 2020, linku: http://orca-ks.org/ëp-content/uploads/2020/11/RAPORTI-I-MONITORIMIT-TE-NARIC-KOSOVA-2.pdf

dhe rajonale, vetëm gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2020, numri i përgjithshëm arrin në 288. Prej tyre, një diplomë është miratuar nga niveli i pestë, 97 diploma janë miratuar nga niveli Bachelor, 114 nga niveli Master dhe 76 nga niveli i doktoratës.

Numri i përgjithshëm i diplomave të njohura për periudhën janar-tetor të vitit 2020, është 663. Vetëm një diplomë është refuzuar në këtë periudhë. Nga niveli i pestë janë miratuar nëntë diploma. Nga niveli Bachelor janë miratuar 250 diploma, ndërsa është refuzuar një e tillë. Në nivelin Master janë miratuar gjithsej 223 diploma, ndërsa në nivelin e doktoratës, janë miratuar 180 diploma nga NARIC Kosova.

Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2020, Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) ka mbajtur dy mbledhje prej të cilave janë njohur 122 diploma ndërkohë që nuk është njohur një.

Përveç diplomave që njihen nga Këshilli Shtetëror për Njohje, njohja e disa diplomave bëhet edhe nga stafi i Zyrës së Qendrës NARIC dhe kjo bëhet vetëm për diplomat e fituara në universitete botërore të mirënjohura si dhe ato publike rajonale. Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2020, zyra NARIC ka njohur gjithsej 139 diploma. Janë njohur 51 diploma të nivelit Baçelor, 68 diploma të nivelit Master dhe 20 diploma të nivelit të doktoratës. Ndërsa gjatë vitit 2021, Zyra e Qendrës NARIC ka njohur gjithsej 526 diploma të nivele të ndryshme të studimit.

Problemet e vitit të kaluar u vazhduan edhe në vitin 2020.

2021

Në periudhën kohore janar-dhjetor të vitit 2021[6], janë marrë gjithsej 1 mijë e 95 vendime rreth njohjes së diplomave nga NARIC Kosova si dhe nga KShNj.

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), për periudhën janar-dhjetor 2021 ka gjithsej 203 diploma të cilat ende gjenden në proces të njohjes dhe për të cilat nuk është dhënë një vendim për njohje apo mosnjohje. Numri i këtyre diplo-

6 RAPORT I MONITORIMIT TË QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE TË DIPLOMAVE (NARIC KOSOVA) 3, NËNTOR 2020 – DHJETOR 2021, linku: http://orca-ks.org/ëp-content/uploads/2022/03/RAPORTI-I-MONITORIMIT-TE-NARIC-KOSOVA-3.pdf

mave që janë lënë pa përgjigje, e të cilat vijnë nga shteti i Shqipërisë është 75, nga shteti i Maqedonisë së Veriut janë 48 diploma, ndërkaq numri i përgjithshëm i lëndëve pa përgjigje nga vendet e tjera është 80.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga kjo qendër, komponenta e validimit të diplomave të fituara brenda Kosovës me qëllim të përdorimit të tyre jashtë vendit, gjatë vitit 2021 ka arritur gjithsej në 3263. Nga institucionet e arsimit të lartë publik, përgjatë vitit 2021 janë validuar gjithsej 1774 diploma, ndërkaq nga institucionet e arsimit të lartë privat janë validuar gjithsej 1489 diploma.

Përtej problemeve të rastisura edhe në vitet e tjera, NARIC Kosova u përballë edhe me disa probleme të reja.

Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj), vazhdon të punojë pa një rregullore të punës dhe pavarësisht kërkesave të kësaj qendre në Ministri të Arsimit, ky dokument ende nuk është realizuar.

Ka vite që Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave në Kosovë, ka vonesa në kthimin e një përgjigjeje palëve apo në njohjen e diplomave të tyre të fituara në Republikën e Shqipërisë. Ky problem vazhdon të mbetet aktual si pasojë e përgjigjeve kontradiktore të institucioneve relevante atje e veçmas për diplomat e fituara në universitetet private në Shqipëri.

Qendrës Kombëtare për Njohje të Diplomave ende nuk i është lejuar krijimi i koncept dokumentit nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Mungesa e një ligji të veçantë që e rregullon punën në NARIC, mbetet një ndër sfidat më të vështira për NARIC-un dhe kjo për arsye se tashmë ka raste në të cilat Gjykata ka obliguar Ministrinë e Arsimit, konkretisht Këshillin Shtetëror për Njohje (KShNj) dhe Qendrën NARIC, që të zbatojë vendimin e saj për njohje të diplomave.

Gjatë vitit 2021, NARIC dhe KSHNJ patën humbur një rast në Gjykatën Themelore në Prishtinë, meqenëse gjykata kishte vendosur që ta njohë gradën Juris Doctor (JD) si ekuivalente me nivelin e tetë të studimeve, pra si doktoratë, gradë kjo e cila në Shtetet e Bashkuara të Amerikës njihet si gradë profesionale pas gradës Baçelor. (Sistemi i Arsimit të Lartë në ShBA dallon nga ai në Evropë.)

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Ankesave dhe zgjedhjes së kontesteve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI), kishte njohur dy diploma. Qendra NARIC e kishte njoftuar kabinetin dhe zyrën e Sekretares së Përgjithshme, e më pas edhe KShNj-në. Sipas qëndrimit të KShNj-së, NARIC ka paditur Komisionin e Ankesave në gjykatën kompetente. Ende nuk ka ndonjë informatë se çfarë është vendosur me rastet.

Gjatë viteve të fundit, shpesh janë bërë publike raste të ndryshme të mashtrimit nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë privat e publik, viktima të të cilëve kryesisht ishin studentët.

Në nëntor të vitit 2021, Ministria e Arsimit themeloi Komisionin për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Kosovë, përmes të cilit synohet të trajtohen rastet të cilat kanë pasur parregullsi në zbatimin e akteve nënligjore për mbajtjen e librave amëz, parregullsi siç është tejkalimi i kuotës së studentëve që mund të regjistrojnë në programe studimore, regjistrimi i studentëve në programe që nuk kanë pasur akreditim, bartja e studentëve nga një program në tjetrin, etj.

2022

Në periudhën kohore janar dhe gusht të vitit 2022, janë marrë gjithsej 725 vendime nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova).

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), për periudhën janar-gusht 2022 ka gjithsej 146 diploma të cilat gjenden në proces të njohjes dhe për të cilat nuk është dhënë një vendim për njohje apo mosnjohje.

Në tetor 2022, QAINT ka mbështetur qendrën NARIC me një rregullore të punës për Këshillin Shtetëror të Njohjes, e cila pritet të hyjë në fuqi shumë shpejt.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS - MENAXHIMI I FINANCAVE

Përmes presionit të hulumtimeve të projektit QAINT, universitetet publike kanë kursyer mbi 1 milion euro që do ishin shpenzuar në shtesa funksionale për profesorë dhe staf menaxherial.


Burimi kryesor prej nga financohen universitetet publike në vendin tonë, vazhdon të mbetet buxheti i Republikës së Kosovës. Ndërkaq transparenca dhe llogaridhënia e këtyre institucioneve është më se e domosdoshme, për t'u treguar se si po ndahen këto mjete dhe cilat janë prioritetet e këtyre universiteteve sa i përket shpenzimit të fondeve publike.

Pjesë e këtij hulumtimi janë stafi akademik i universiteteve publike me këto pozita menaxheriale: anëtar i Këshillit Drejtues, rektor, prorektor, dekan dhe prodekan. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të gjejë dhe të sjellë informata rreth pagave bazë me të cilat paguhen këta zyrtarë sipas rregulloreve për të ardhura personale dhe mëditjeve apo shtesave që marrin.

Deklarimet e pasurisë të stafit akademik menaxherial të të gjitha universiteteve publike në Kosovë janë të publikuara në uebfaqen e Agjencisë Kundër Korrupsion. Në këto deklarime stafi akademik menaxherial deklaron të ardhurat e tyre vjetore nga buxheti i universitetit/qeverisë. Këto të ardhura vjetore janë pjesëtuar për muaj, dhe nga shuma mujore janë zbritur paga bazë e caktuar sipas rregulloreve respektive për të ardhura personale të


universiteteve. Pjesa e mbetur janë shtesa të dhëna nga universitetet për shërbime të ndryshme, si: shtesa për pozita menaxheriale (rektor, prorektor, dekan, prodekan, këshill drejtues, etj.), shtesat për mbi-norma (orë shtesë/honorare), si dhe shtesat për mentorime të temave të diplomës (BA, MA dhe PhD).

TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE




Sipas pozitave menaxheriale:


TË ARDHURAT DHE SHTESAT E REKTORËVE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE




TË ARDHURAT DHE SHTESAT E PROREKTORËVE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE



TË ARDHURAT DHE SHTESAT E DEKANËVE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE




TË ARDHURAT DHE SHTESAT E PRODEKANËVE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE




Sipas universiteteve:


TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS PËRGJATË VITEVE




TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E PRIZRENIT PËRGJATË VITEVE




TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E PEJËS PËRGJATË VITEVE




TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS PËRGJATË VITEVE




TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS PËRGJATË VITEVE



TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E GJILANIT PËRGJATË VITEVE



TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E FERIZAJIT PËRGJATË VITEVE



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS – TRANSPARENCA FORMALE

Përmes presionit të hulumtimeve të projektit QAINT, universitetet publike kanë përmirësuar transparencën e dokumenteve të tyre. Këto universitete po ashtu kanë punuar në hartimin e rregulloreve të reja, dhe Statuteve permanente të tyre.

Në Kosovë, kemi shtatë universitete publike të cilat burim kryesorë financiar kanë buxhetin e shtetit. Përmes transparencës formale, këto institucione mund të marrin hapat e parë për të dhënë transparencë të mirëfilltë dhe llogaridhënie qytetarëve të Kosovës.

Me transparencë formale në këtë dokument, kuptohet ofrimi i qasjes formale në informacion nga ana e universiteteve publike për publikun përmes faqeve elektronike të tyre.


ORCA prej vitit 2019 ka grumbulluar të dhëna mbi ekzistencën e 27 dokumenteve dhe informatave nga universitetet publike, të cilat përbëjnë informacionin më bazik rreth funksionimit të tyre. Të dhënat janë grumbulluar nga ueb faqet zyrtare të 7 universiteteve publike në vendin tonë (Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Pejës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjakovës, Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Gjilanit, dhe Universiteti i Ferizajt), të cilat përbëjnë informacionin më bazik rreth funksionimit të tyre.

Këto dokumente përfshijnë: *Raporti student/ mësimdhënës, Statuti i Universitetit , Plani strategjik , Kodi i etikës, Rregullore disiplinore, Rregullorja për zgjedhjen e stafit akademik,*


Rregullorja për bashkëpunëtorë, Buletinet, CV-të e stafit, Rregullorja për të ardhurat personale, Rregullorja për zgjedhjet studentore, Përbërja e Parlamentit, Përbërja e rektoratit, Përbërja e Këshillit Drejtues, Përbërja e Senatit, Vendimet e Senatit, Vendimet e Këshillit Drejtues, Vendimet e Rektorit, Vendimet e akreditimit, Rregullorja për studimet BA, Rregullorja për studimet MA, Rregullorja për studimet PhD, Rregullorja për SEMS, Rregullorja për sigurimin e cilësisë, Planprogramet, dhe Informacione për bursa/punësim.

Në vijim janë grafikat e secilit universitet përgjatë viteve në transparencë formale.


UNIVERSITETI I PRISHTINËS




UNIVERSITETI I PEJËS




UNIVERSITETI I MITROVICËS




UNIVERSITETI I PRIZRENIT




UNIVERSITETI I GJILANIT



UNIVERSITETI I GJAKOVËS



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ



INTEGRITETI AKADEMIK, PUBLIKIMI SHKENCOR, DHE JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETE PUBLIKE


Hulumtimi mbi integritetin akademik dhe publikimin shkencor në universitete publike vjen si rrjedhojë e nevojës së publikut për t'u informuar rreth cilësisë së arsimit në universitete publike, të cilat kryesisht financohen nga taksapaguesit. Vlerësimi i cilësisë së arsimit në universitete publike dhe kritika racionale ndaj parregullsive eventuale në këto universitete, sipas ORCA-s ndikon në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

ORCA ka bërë shqyrtimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, të përcaktuara si kriter nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, statutet e universiteteve publike për zgjedhje në njërin nga titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt, Udhëzimet Administrative 01/2018 dhe 07/2018, si dhe rregulloret për përzgjedhje, avancim dhe emërim të personelit akademik në universitete publike. Objekt i shqyrtimit janë CV-të e publikuara të stafit akademik.


Hulumtimi është bërë në periudha të ndryshme për universitete publike, në qershor 2021 për të gjitha, dhe në tetor 2022 për të gjitha pa përfshirë Universitetin e Prishtinës.

Rritet justifikimi i titujve në të gjitha universitetet publike nga 2019 në 2022, përmes rritjes së publikimeve shkencore. Ulet numri i publikimeve të dyshimta, dhe i profesorëve që nuk kanë asnjë punim shkencor.


MESATARJA E JUSTIFIKIMIT TË TITUJVE NË UNIVERSITETE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE



PUBLIKIMET SHKENCORE NË UNIVERSITETE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE




PUBLIKIMET E DYSHIMTA NË UNIVERSITETE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE




Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Prishtinës


JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS PËRGJATË VITEVE




PROFESORË PA ASNJË PUNIM SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS PËRGJATË VITEVE




PUNIMET SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS PËRGJATË VITEVE



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS PËRGJATË VITEVE




PUNIME TË DYSHIMTA NË UNIVERSITETIN
E PRISHTINËS PËRGJATË VITEVE




Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Mitrovicës


JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS PËRGJATË VITEVE




PROFESORË PA ASNJË PUNIM SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS PËRGJATË VITEVE




PUNIMET SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS PËRGJATË VITEVE



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS PËRGJATË VITEVE




PUNIME TË DYSHIMTA NË UNIVERSITETIN
E MITROVICËS PËRGJATË VITEVE




Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Gjakovës


JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS PËRGJATË VITEVE




PROFESORË PA ASNJË PUNIM SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS PËRGJATË VITEVE




PUNIMET SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS PËRGJATË VITEVE



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS PËRGJATË VITEVE




PUNIME TË DYSHIMTA NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS PËRGJATË VITEVE




Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Prizrenit


JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN E PRIZRENIT PËRGJATË VITEVE




PROFESORË PA ASNJË PUNIM SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E PRIZRENIT PËRGJATË VITEVE




PUNIMET SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E PRIZRENIT PËRGJATË VITEVE



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR NË UNIVERSITETIN E PRIZRENIT PËRGJATË VITEVE




PUNIME TË DYSHIMTA NË UNIVERSITETIN
E PRIZRENIT PËRGJATË VITEVE




Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Pejës


JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN E PEJËS PËRGJATË VITEVE




JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN E PEJËS PËRGJATË VITEVE




PUNIMET SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E PEJËS PËRGJATË VITEVE



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR NË UNIVERSITETIN E PEJËS PËRGJATË VITEVE




PUNIME TË DYSHIMTA NË UNIVERSITETIN
E PEJËS PËRGJATË VITEVE




Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Gjilanit


JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN
E GJILANIT PËRGJATË VITEVE




PROFESORË PA ASNJË PUNIM SHKENCOR
NË UNIVERSITETIN E GJILANIT PËRGJATË VITEVE




PUNIMET SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E GJILANIT PËRGJATË VITEVE



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR NË UNIVERSITETIN E GJILANIT PËRGJATË VITEVE




PUNIME TË DYSHIMTA NË UNIVERSITETIN E GJILANIT PËRGJATË VITEVE




Integriteti akademik, publikimi shkencor, dhe justifikimi i titujve në Universitetin e Ferizajit


JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN E FERIZAJIT PËRGJATË VITEVE




PROFESORË PA ASNJË PUNIM SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E FERIZAJIT PËRGJATË VITEVE




PUNIMET SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E FERIZAJIT PËRGJATË VITEVE



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR NË UNIVERSITETIN E FERIZAJIT PËRGJATË VITEVE



PUNIME TË DYSHIMTA NË UNIVERSITETIN
E FERIZAJIT PËRGJATË VITEVE



DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit "Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë – QAINT". Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center

ORCA organizata për mbjen e cilësisë në arsim

ZSI Centre for Social Innovation